



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Vendimi nr.51/18

Data: 22.06.2018

Në bazë të nenit 13,15,17,18,19,20, dhe çështjet procedurale bazuar në nenin 28,29,35.2, neni 50, neni 54 paragrafi 1.3 dhe 1.9 Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 8 i Plotësim Ndryshimit të Ligji nr. 04/L-226, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi 1.3 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, UA Nr.02./2011 Mbi Mënyrën dhe Kriteret Për Konstatimin e Tregut Përkatës, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e datës 22.06.2018, mori këtë:

V E N D I M

- I. **LEJOHET**, Përqendrimi përmes përfitimit 100% të kontrollit nga NKL Limited, në cilësinë e blerësit **mbi** NewCo Ferronikeli Complex LLC-Cunico, në cilësinë e shitësit.
- II. **Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim** obligohet të paguaj taksën administrative për Autorizimin lidhur me Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja (tre mijë euro).
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga ana e Komisionit.

A R S Y E T I M

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, e paraqitur në bazë të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji nr. 04/L-226, neni 18 par 6, neni 19 par 5, neni 28, paragrafi (1,2), neni 35 paragrafi (2), Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, publikimin e Njoftimit për qëllimin e realizimit të përqendrimit në web faqën e AKK me datën 12.06.2018, Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 05.06.2018.

Njoftimi për Përqendrim ka të bëjë me:

Blerjen e 100% të kuotave, të nënshkruara më datën 10.05.2018 dhe vendimin e datës 16.05.2018 (Kontratë e Shitblerjes) ndërmjet NKL Limited ne cilësinë e blerësit dhe NewCo Ferronikeli Complex LLC , në cilësinë e shitësit.

Ndërmjet Kontratës së Shitblerjes do të realizohen transferimi i 100% i pronësisë së NewCo Ferronikel Complex LLC tek NKL Limited.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, 15, 19 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) qarkullimi i kombinuar i palëve në mbarë botën, kalon shumë 20 milion euro
- b) Njëra nga palët blerëse është e regjistruar në Republikën e Kosovës
- c) Kontrata e Shitblerjes ndërmjetës palëve, datë 24.04.2018.

Vlerësimi i transaksionit në raport Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës në tregun përkatës, nga taransaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar është transaksion që nuk ka efekt në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës, por vetëm në atë ndërkombëtar. Nga transaksioni nuk do të rezultojnë efekte negative për konkurrencën e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës.

Autoriteti vlerëson se autorizimi për këtë përqendrim do të vlerësohet vetëm në fazën e parë, si në vijim ;

Në rastet kur Autoriteti në procedurë të shkurtër duhet të vlerëson qëllimin e realizimit të përqendrimit, atëherë ndërmarrja i dorëzon Autoritetit një njoftim të shkurtër për përqendrimin. Procedura e shkurtër e vlerësimit të qëllimit të realizimit të përqendrimit bëhet veçanërisht në raste si vijon:

- *Kur asnjë pjesëmarrës në përqendrim nuk vepron në tregun e njëjtë relevant në kuptimin gjeografik dhe produktit dhe kur në mes tyre nuk ka marrëveshje horizontale, apo kur asnjëri nga pjesëmarrësit nuk vepron në tregun në të cilin rëniat dhe ngritjet, në raport me tregun në të cilin vepron pjesëmarrësi tjetër i përqendrimit nuk ka lidhje vertikale.*

Një ndër specifikat e realizimit të përqendrimit potencial dhe poashtu sipas kërkesës për qëllimin e përqendrimit konkludojmë se nuk është e nevojshme të evaluohet pozita dhe pjesëmarrja në treg si dhe fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjes-blerësit në tregun relevant, shkallën e aftësisë konkurruese të pjesëmarrësve në përqendrim, sepse TARGETI nuk ka konkurrent në Republikën e Kosovës e gjithashtu tregu i TARGETIT nuk është Kosova, **e sa i përket pozitës së NKL Limited, të njëjtët janë blerës që lindin si pasojë e përqendrimit.**

Vëmendje - Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative .

Me këtë Vendim të njoftohen:

- *Pala*
- *Arkiva*

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**

(_____)

Valon Prestreshi
Kryetar

(_____)

Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar

(_____)

Fatime Haziri
Anëtare

(_____)

Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)

Shaqir Morina
Anëtar